AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
Nr. 3468 Prot.
Datë,më 02.09.2022

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

SHKOLLA TEKNIKE ELEKTRIKE "GJERGJ CANCO"

Nr/142 prot Tiranë, më 25.08.2022

Lënda: Njoftim për lëvizje paralele

**DREJTORISË SË SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**

**DREJTORISË SË MARËDHËNIEVE ME PUBLIKUN**

**AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE**

Në zbatim të ligjit nr. 15/2019, "Për nxitjen e punësimit"; të ligjit nr. 15/2017, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë"; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 554, datë 31.7.2019, "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe funksionimit të të Agjencisë Kombëtare të punësimit dhe aftësive"; të udhëzimit nr.14, datë 27.5.2021, "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesëve publikë të arsimit dhe formimit profesional",

Shkolla Teknike Elektrike"Gjergj Canco"Tiranë, ju njofton krijimin e vendit të lirë për pozicionin:

- Mësimdhënës të teorisë profesionale të drejtimit Elektroteknikë

1. Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posacme

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme për lëvizjen paralele si vijon:
a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar:
b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe të motivimit.

Aplikanti për mësimdhënës të teorisë profesionale duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon:

a) të ketë diplomë të nivelit master profesional ose të barasvlershme, në të njëjtën fushë me kualifikimin profesional të kërkuar;
b) Të ketë të paktën 1 (një) vit përvojë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet;
c) Të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit;

Dokumentet e aplikimit

2. Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar, sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

a) letërmotivimin për pozicionin;
b) jetëshkrimin (CV-në);
c) kartën e identitetit;
d) diplomën;
e) librezën e punës;
f) çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;
g) certifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
h) vërtetimin e gjendjes shëndetësore;
i) vërtetimin e gjendjes gjyqësore;
j) vërtetimin nga punëdhënësi i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi
k) të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënës të mëparshëm.

3. Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopjo të noterizuara të tyre. Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyera dhe të noterizuara.

4. Dokumentet e aplikimit dorëzohen në zyrën e protokollit të shkollës, brenda datës 12.09. 2022.

**DREJTORE**

**Hedie Gjoni**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHKOLLA E MESME TEKNIKE-ELEKTRIKE "GJERGJ CANCO"
TIRANË